

Data 29.12.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT- 79995100-6 -
Shërbime të arkivimit.

VLERA E FONDIT LIMIT: : **54,806,666 (pesëdhjetë e katër million e tetëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë**, pa TVSH, ose **565,600.2 (peseqind e gjashtëdhjetë e pese mijë e gjashtëqind pike dy) euro** pa TVSH. *Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 29.12.2025, 1 euro = 96.9 All..*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Ne zbatim te Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit kemi te bejme me nje arkive qendrore e cila ka ne administrim te gjithë dokumentacionin e shoqerive dhe do te integrohet me sistemin qendror i cili bazohet dhe karakterizohet nga nderlidhja e pashmangshme e me sistemet ekzistuese. Ndarja ne lote do ta bente te pa ekezekutueshme kontraten pasi eshte nje sistem kompleks dhe i perqendruar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rendesinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: “*Tatimpaguesit*

e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje shërbimesh,

pavaresisht rendesise dhe kompleksitetit te shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe ne frymen e konkurueshmerise qe gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar qe OE ofertues te ketë bërë/realizuar me kontrata te ngjashme, te jetë rreth 35 % e vlerës (ne vijimesi edhe me LLP te meparshem) dhe ne këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë qe OE ofertues do jete realisht ne gjendje te realizoje kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurinë e punës se AK.

2.3.2 Per autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si certifikata ISO ku operatori ekonomik duhet të deshmojë se eshte i paisur me certifikatat:

- **ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit te Cilesise ose ekuivalente**, (e vlefshme) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;
- **ISO/IEC 20000-1:2018 (ose ekuivalente), lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit**, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;
- **ISO 27001:2022 (Certifikimi për sigurinë e Informacionit) ose ekuivalente**, (e vlefshme) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;*Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.*

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë percaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deshmojnë që si kompani kanë kualifikimet / çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.3 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të ketë të punësuar për të paktën muajin e fundit (*nga data e publikimit të njoftimit të kontratës*) **10 (dhjetë) Specialiste** dhe të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhim Projektsh PMP (Project Management Professional), Prince 2 ose ekuivalent.
- b) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhimin e Shërbimeve në (ITIL), ose ekuivalent.
- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së skanerit që do të ofertojë, ose ekuivalent.
- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së rrjetit që do të ofertojë, ose ekuivalent.
- e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i Network Array Storage që do të ofertojë, ose ekuivalent.
- f) Të paktën 2 (dy) specialist, të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione çertifikuese ndërkombëtare, ose ekuivalent.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për të gjithë punonjësit e mesiperm pjesë e stafit të punësuar nga vete OE, duhet të paraqiten certifikatat përkatëse të kualifikimit/ Transkriptet përkatëse si dhe operatori ekonomik duhet të vërtetojë se i ka të punësuar për periudhën e dates së hapjes së tenderit.

Një punonjes mund të ketë një ose disa certifikime/ Transkriptet përkatëse, për të përmbushur kriteret e mesiperme për certifikimet. Si përmbledhje, operatori ekonomik duhet të paraqes:

- *Certifikatat përkatëse të kualifikimit për secilin nga specialistët e mesiperm.*
- *Listepagesat e punonjësve dorëzuar nëpërmjet formës elektronike në organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vërtetues, për muajin e fundit;*

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

Argumentimi: Ne baze të pikes 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me ane të këtij kriteri kerkohet që operatorët ekonomike të deshmojnë që kanë personelin minimal të nevojshëm për realizimin me sukses të kontrates.

Argumentimi Teknik i stafit:

- g) **Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhim Projektesh PMP (Project Management Professional), Prince 2 ose ekuivalent.**

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Menaxheret e projektit janë përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të sigurojë që çdo pikë e shërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të kësaj kontrate. Gjithashtu vlen të theksohet që me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj).

- h) **Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhimin e Shërbimeve në (ITIL), ose ekuivalent.**

Argumentimi: Kërkesa për një punonjës të certifikuar për "ITIL" lidhet me rezultatet që duhet të përmbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave të shprehura në DST ku përcaktohen kohët e ndërhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirëmbajtjes). Një certifikim ITIL është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e

shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kërkesa për çertifikim ITIL, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të çertifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes.

- i) Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së skanerit që do të ofertojë, ose ekuivalent.**

Argumentimi: Kërkesa për të paktën një (1) specialist të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së skanerit (ose ekuivalent) është e domosdoshme për të garantuar instalimin, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin korrekt të pajisjes sipas standardeve të prodhuesit. Certifikimi zyrtar siguron që specialisti zotëron njohuri të thelluara mbi arkitekturën e sistemit, protokollet e sigurisë, diagnostikimin e defekteve dhe ndërhyrjet teknike të avancuara, duke minimizuar rrezikun e keqfunksionimeve, ndërprerjeve të shërbimit dhe humbjes së të dhënave. Gjithashtu, prania e një specialisti të certifikuar garanton mbështetje teknike të kualifikuar gjatë gjithë ciklit jetësor të pajisjes dhe përputhshmëri me kërkesat e garancisë së prodhuesit.

- j) Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së rrjetit që do të ofertojë, ose ekuivalent.**

Argumentimi: Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së rrjetit që ofertohej, ose ekuivalent, është e nevojshme për të garantuar projektimin, implementimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e saktë të infrastrukturës së rrjetit në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të prodhuesit. Certifikimi profesional siguron që specialisti disponon njohuritë teknike të nevojshme për menaxhimin e protokolleve të rrjetit, sigurisë, performancës dhe ndërveprimit me sistemet ekzistuese, duke reduktuar rrezikun e dështimeve teknike, ndërprerjeve të shërbimit dhe cenimit të sigurisë së të dhënave. Gjithashtu, prania e një specialisti të certifikuar garanton mbështetje teknike të kualifikuar gjatë gjithë ciklit jetësor të sistemit dhe respektimin e kushteve të garancisë së prodhuesit.

- k) Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i Network Array Storage që do të ofertojë, ose ekuivalent.**

Argumentimi: Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i Network Array Storage që ofertohej, ose ekuivalent, është e domosdoshme për të garantuar instalimin, konfigurimin, integrimin dhe mirëmbajtjen e sigurt dhe efikase të sistemit të ruajtjes së të dhënave. Certifikimi profesional siguron që specialisti zotëron njohuri të avancuara mbi arkitekturën e storage-it, menaxhimin e kapaciteteve, performancës, replikimit, backup-it dhe

mekanizmave të sigurisë, duke minimizuar rrezikun e humbjes së të dhënave, ndërprerjeve të shërbimit dhe degradimit të performancës. Gjithashtu, prania e një specialisti të certifikuar garanton mbështetje teknike të kualifikuar gjatë gjithë ciklit jetësor të pajisjes dhe përputhshmëri me kërkesat e garancisë dhe standardeve të prodhuesit.

l) Të paktën 2 (dy) specialist, të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione certifikuese ndërkombëtare, ose ekuivalent.

Argumentimi: Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione certifikuese ndërkombëtare, ose ekuivalent, është e nevojshme për të garantuar administrimin e saktë, të sigurt dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të ciklit jetësor të dokumenteve dhe të dhënave digjitale. Certifikimi ndërkombëtar siguron që specialistët disponojnë njohuri të avancuara mbi klasifikimin, ruajtjen afatgjatë, aksesin, integritetin, autenticitetin dhe mbrojtjen e arkivave digjitale, si dhe mbi politikat e arkivimit dhe përputhshmërinë me legjislacionin përkatës. Prania e dy specialistëve garanton vazhdimësinë e shërbimit, ndarjen e përgjegjësiwe kritike dhe reduktimin e rrezikut operacional, duke siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe cilësor të sistemit të menaxhimit të arkivave digjitale.

2.3.4 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë me të dhënat teknike, për mallrat me Nr Rendor 4,5,6,7,8,9,10. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme paisjet e sipërcituara që ofertohen sipas modelit të deklaruar dhe të shenohen (me nje tjetër ngjyre) specifikimet përkatëse sipas të dhënave qe kerkohen në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të paisjeve të kërkuara me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerinë e tyre.

2.4.2 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojë:

- që merr përsipër montimin, instalimin, konfigurimin e pajisjeve dhe sistemit, si dhe trajnimin e stafit përkatës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termat e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit: